

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Oficer i Shendetit dhe Sigurise ne Pune

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Oficer i Shendetit dhe Sigurise ne Pune eshte pergjegjes per implementimin dhe zbatimin e “Rregullores se sigurimit teknik per punen ne ndertim”, “Rregullores dhe sistemit te Menaxhimit te ISO 45001:2018” te kompanise Gener2, Legjislacionin e Sigurise te pergjithshem dhe per kantieret e ndertimit te kompanise.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Realizon trajnimin baze ne kantier dhe trajnimet specifike per personelin e kantierit sipas programit te hartuar te trajnimeve;
- Instrukton puntoret, inxhinieret dhe manovratorët për të ulur rreziqet e aksidenteve të mundshme;
- Eshte pergjegjes per kontrollin e implementimit te Planit te Sigurise dhe Kordinimit ne Kantier;
- Eshte pergjegjes per trajnimin dhe implementimin ne raste emergjencash te procedurave te parashikuara ne Planin e Sigurise dhe Kordinimit;
- Kontrollon qe metodologjia e punes se aplikuar eshte ne perputhje me instruksionet e sigurta te punes;
- Kerkon nderprerjen e cdo aktiviteti pune te zhvilluar jashte standartit te sigurise dhe qe prezanton rrezik eminent per stafin;
- Realizon inspektimet ditore sipas programit te inspektimeve duke plotesuar dokumentacionin perkates sipas procedures te Oficerti te Sigurise;
- Ploteson regjistrin e inspektimeve dhe monitoron plotesimin e masave te sigurise duke e raportuar ate te HS Manager me frekuence javore;
- Ploteson listat e kontrollit per punimet specifike sipas planit te inspektimeve;
- Mban statistikate e incidenteve ne kantier;
- Eshte pergjegjes per kontrollin e implementimit e te gjitha masave parandaluese dhe mbrojtese te specifikuara ne Planin e Sigurise dhe Kordinimit;
- Ekzaminon dokumentacionin e makinerive, ambjentin e punes dhe strukturat, ben matjet e zhurmave, nxehjes dhe vibrimeve dhe i evidenton ato me paisjet perkatese;
- Ekzaminon puntoret per paisjet e pershtatshme personale te sigurise, sic jane syzet, kufjet, dorezat dhe veshje pune te pershtatshme;
- Ekzaminon dokumentacionin ligjor te sigurise dhe shendetit ne pune te detyrueshem ne kantier;
- Investigon masat qe jane marre per tu mbrojtur nga semundjet profesionale;
- Investigon procedurat e punes ne ambjente te rrezikshme ose punes me substance potencialisht te rrezikshme.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit / Preferohet Inxhinier Ndertimi

Certifikime: Certifikata sigurie si “Pergjegjes i Sigurise dhe Shendetit ne Pune”, “Koordinator i Sigurise” ose certifikata te tjera ne fushen e sigurise.

Gjuhe te huaja: Anglisht, Italisht

Njohuri kompjuterike: Msc Office, Autocad, Project

Eksperienca e kerkuar: Mbi 3 vjet ne fushen e ndertimit. Mbi 2 vit ne sigurimin teknik.

Te jete i gatshem per te punuar jashte Tirane

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dërgojnë CV nëpërmjet adresës së e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 03 Prill 2026, ora 17:00.**

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”